



The Human Rights Advisory Panel

UNMIK HQ, East Wing, 10000 Pristina, Kosovo

VENDIM

Data e vendimit: 6 qershor 2008

Lënda Nr. 04/07

Kadri BALAJ, (në emër të Mon BALAJ), Shaban Xheladini (në emër të Arben XHELADINI), Zenel ZENELI dhe Mustafa NERJOVAJ

Kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillimor për të Drejtat e Njeriut i mbledhur më 6 qershor 2008 me këtë përbërje:

Z. Marek NOWICKI, kryesues

Z. Paul LEMMENS

Znj. Snezhana BOTUSHAROVA-DOICHEVA

Z. John RYAN, Zyrtar ekzekutiv

Pas pranimit të ankesës së lartpërmendur, të paraqitur në bazë të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, e datës 23 mars 2006, mbi Themelimin e Panelit Këshillimor për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të bërë, vendosë si vijon:

I. FAKTET

1. Më 10 shkurt 2007, protesta e cila qe organizuar në Prishtinë nga Vetëvendosja u bë e dhunshme. Njësi policore të formuara prej shumë shteteve nga UNMIK-u (FPU), duke përfshirë Rumaninë, ishin pozicionuar për të mbrojtur ndërtesat qeveritare dhe për të mbajtur turmën nën kontroll, nëse e nevojshme.

2. Gjatë kësaj proteste lëndime kishin marrë policia dhe protestuesit. Policia e UNMIK-ut kishte shtënë me plumba gome në drejtim të turmës, dhe me atë rast u vra Mon Balaj, i biri i palës ankuese të parë, dhe Arben Xheladini, i biri i palës ankuese të

dytë, dhe u plagosën edhe të tjerë, disa mjaft rëndë, duke përfshirë Zenel Zenelin dhe Mustafa Nerjovaj, pala ankuese e tretë dhe e katërt.

3. Pas protestës, ishte formuar një grup punues për të hetuar rrethanat e protestës dhe të dhunës së paraqitur. PSSP-ja kishte caktuar një prokuror special, i cili kishte paraqitur dy raporte, datë 16 prill 2007 dhe 29 qershor 2007.

Raporti i datës 16 prill 2007, përmban këto gjetje lidhur me palët ankuese të kësaj lënde:

“A. Mon Balaj – vrasjen e Mon Balajt e kishin parë një numër i njerëzve. E qartë është se, gjatë protestës ai hyri në hotelin Iliria, rruga Nëna Tereze. Mirëpo, ai doli me vrap nga hoteli, kërceu nga terasa dhe menjëherë pas kësaj ishte qëlluar në kokë, prapa veshit të djathtë me një plumb gome, i cili i kishte shpuar kafkën. Ai vdiq nga plaga e shkaktuar në kokën nga plumbi i gomës i llojit RB1. Mon Balaj kishte hyrë në hotelin Iliria, rruga Nëna Tereze dhe kur MSU (Njësitë Speciale Multinacionale) hynë në hotel, ai doli me vrap nga hoteli, kërceu nga terasa dhe u rrëzua, meqë ishte goditur prej plumbit. Autopsia ishte kryer dhe plumbi ishte gjetur. Plumbi ishte i llojit RB1.

B. Arben Xheladini – pak dihet për rrethanat e shtënies dhe vdekjes së Arben Xheladinit. Ai ishte qëlluar në ballë. Autopsia ishte kryer dhe plumbi ishte gjetur. Plumbi ishte i llojit RB1, plumb i gomës.

C. Mustafa Nerjovaj – Ai ishte qëlluar në kokë me plumb RB1. Plumbi ishte gjetur dhe analizuar. Plaga i qe shkaktuar kur ai ishte përkulur për të marrë kutinë me gaz lotsjellës për t'ia hedhur prapa policisë. Plumbi ishte i llojit RB1, plumb i gomës.

D. Zenel Zeneli – ishte qëlluar në gjoks dhe plumbi i kishte ngelur aty. Atij nuk i kujtohen hollësitë e shkaktimit të lëndimeve të tij. Nga fotografimi me rreze iks, shihet se plumbi i ngelur në gjoksin e tij ishte plumb RB1. “

I njëjti raport përmban konstatimet në vijim:

“A. Provat e deri tanishme çojnë në konkludimin se, vdekja e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit ishin të panevojshme dhe të shmangshme. Duket se nuk ka pasur justifikim për të qëlluar në kokë Mon Balajn dhe Arben Xheladinit, ose në gjoks Zenel Zenelin. Qëllimi i planit operacional ishte mbrojtja e ndërtesave dhe kontrolli i turmës. Shakaktimi i plagëve fatale dhe i plagëve gati fatale u bë nga një distancë e konsiderueshme prej ndërtesave qeveritare, që duheshin mbrojtur. Mbretëron edhe konstatimi se, përdorimi i plumbave të gomës gjatë asaj dite ishte këshillë jo e mirë dhe e papërshtatshme nën ato rrethana. Kjo do të jetë çështje për hetime të mëtejme.

B. Provat e deri tanishme mbështesin konstatimin se, plumbat fatal dhe gati fatal ishin shkrepur prej një ose dy pjestarëve me pushkë të Njësitë të Formuara Policore (FPU). Atë ditë ishin 10 pjestarë të FPU-së rumune që mbanin pushkë. Pjestarët rumunë që mbanin pushkë kishin shkrepur 56 plumba të gomës, të llojit RB1. Së paku tetë pjestarë rumunë që mbanin pushkë kishin shkrepur këta 59 plumba të llojit RB1. Mirëpo provat, nuk sigurojnë një bazë që do të çonte në identifikimin e personave, të cilët kishin shkrepur municionin e vet me plumba RB1, që ishin vdekjeprues dhe plagosës. Shkalla e provave të mbledhura deri më tani, nuk arrinë nivelin e dyshimit të arsyeshëm për aktivitet kriminal të kryer nga ndonjë person i caktuar. Prandaj, iniciimi zyrtar i procedurës penale, në bazë

të nenit 220 dhe 221 të (Kodit të Procedurës Penale të Kosovës) aktualisht nuk mund të autorizohet.

C. Në dritën e asaj që u tha më lart, UNMIK-u, Kombet e Bashkuara dhe Qeveria e Rumanisë mund të marrin parasysh iniciimin e procedurave të përshtatshme për kompensim të familjarëve të afërm të atyre që u qëlluan për vdekje dhe të atyre që u plagosën rëndë.”

Raporti i datës 29 qershor 2007, përmban “një rishikim të ligjit mbizotërues dhe një vlerësim dhe kritikë të praktikave dhe procedurave të përdorura nga policia e UNMIK-ut, gjatë planifikimit dhe zbatimit të funksioneve të policisë para dhe gjatë protestës së datës 10 shkurt, meqë kjo në veçanti ka të bëjë me vendimin për përdorimin e plumbave të gomës kundër turmës, në atë ditë”. Raporti konstaton se, ka pasur të lëshime të ndryshme lidhur me kornizën ligjore dhe planifikimin, operacionin dhe procesin e vendimmarrjes.

4. Bordi i UNMIK-ut për shqyrtimin e kërkesave, që i raporton Drejtorit për përkrahje të misionit të UNMIK-ut, ka shqyrtuar kërkesat për kompenzim, të paraqitura nga familjet e palëve ankuese. Për rastin e Mustafa Nerjovajt, ishte rekomanduar që shqyrtimi i kërkesës të shtyhej deri në sigurimin e dokumentacionit shtesë. Për rastet e tjera, rekomandimet për kompenzim i janë përcjellur Bordit për shqyrtim të kërkesave, në selinë qendrore, më 27 dhjetor 2007, për shqyrtim të mëtutjeshëm. Deri më tani, nuk është bërë asnjë pagesë palëve ankuese apo familjeve të tyre.

II. ANKESAT

5. Palët ankuese pretendojnë se faktet për vrasjet dhe lëndimet serioze të palëve ankuese përbëjnë shkelje të të drejtave të paraqitura në vijim: e drejta për jetë, ndalim të torturës, e drejta për mjete juridike, e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta për tubim paqësor.

Ato përfshijnë instrumentet ndërkombëtare për të drejta të njeriut, si vijon:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në veçanti nenet 3, 5, 8 10 dhe 20;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR), në veçanti nenet 2, 3, 6, 11 dhe 13;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (CCPR), në veçanti nenet 2, 6, 7 dhe 21;
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, në veçanti nenet, 2, 10, 12, 13, 14 dhe 16;

III. SEANCA PARA PANELIT

6. Ankesa ishte paraqitur më 11 tetor 2007 dhe ishte regjistruar në po të njëjtën datë.

7. Paneli ia ka komunikuar rastin PSSP-së, më 7 shkurt 2008, me mundësi për dhënien e komenteve në emër të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe meritat, në bazë të nenit 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 dhe Rregullës 30 të Rregullores së punës të panelit. PSSP-ja nuk e kishte shfrytëzuar këtë mundësi.

IV. LIGJI

8. Para shqyrtimit të lëndës, në bazë të meritës, Paneli duhet të vendosë nëse duhet të pranojë lëndën, duke pasur parasysh kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me nenin 1,2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

A. Nëse janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë për qëllim të shqyrtimit

9. Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, përcakton se, Paneli këshillimor mund të merret me çështjen, pasi të ketë përcaktuar, nëse janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë e tjera të disponueshme për shqyrtimin e shkeljeve të deklaruara.

Palët ankuese paraqesin se, pas dy raporteve të Prokurorit special, nuk qe inicuar asnjë hetim. Kjo për shkak të imunitetit të UNMIK-ut dhe personelit të tij, asnjë mundësi tjetër për shqyrtim nuk ka qenë e disponueshme për ta.

10. Lidhur me këtë, Paneli vlerëson se, çështja, nëse kërkesa për të shterrur të gjitha mjetet tjera është përmbushur për këtë rast është ngusht e lidhur me ankesat, përkritazi me aspektin e procedural të të drejtës për jetë dhe ndalimin e keqtrajtimit dhe ekzistimit të një mjeti juridik efektiv. Pikëpamja e Panelit lidhur me këtë çështje është se, ajo adresohet në mënyrë më të përshtatshme, duke bërë një analizë të përgjithshme dhe duke pasur parasysh mjetet juridike, të cilat janë të disponueshme për palët ankuese, fusha e obligimeve që dalin në këtë kontekst, sipas instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të përfshira nga palët ankuese, dhe gjithashtu edhe për përgjigjen e dhënë nga autoritetet për përdorimin e mjeteve juridike nga ana e palëve ankuese. Në përputhje me rrethanat, çështjet relevante duhen bashkuar në bazë të meritës së lëndës.

B. Nëse ankesa është paraqitur si e pabazë

1. Edrejta për jetë

a. Parashtrësat e palëve ankuese

11. Duke u mbështetur në dy raportet e paraqitura nga Prokurori special për PSSP-në, palët ankuese pohojnë se, të katër viktimat ishin vrarë ose plagosur rëndë nga plumbat e gomës, që ishin shkrepur nga FPU-ja rumune e policisë së UNMIK-ut. Sipa palëve ankuese, plumbat e gomës, të shkrepur nga policia rumune ishin jashtë përdorimit, nuk kishte justifikim ose arsye për të shtëna, ndërsa plumbat e gomës ishin përdorur në një mënyrë, e cila ishte në kundërshtim me udhëzimet relevante mbi metodat e drejta të shkrepjes së projektilëve të tillë.

Duke iu kthyer rrethanave lidhur me të shtënat, palët ankuese pohojnë se, ekzistonte një dallim domethënës ndërmjet ligjit rumun dhe standardeve të pranuar ndërkombëtarisht për përdorimin e armëve të zjarrit dhe forcës vdekjepruese: i pari lejon përdorimin në një shkallë më të madhe të armëve të zjarrit dhe të forcës vdekjepruese. Më tutje, palët pohojnë se, urdhëri operacional për t'u marrë me demonstratën e datës 10 shkurt 2007, ishte i dykuptimtë, për faktin nëse kishte patur një autorizim për përdorimin e plumbave të gomës, ose jo. Përfundimisht, sipas palëve ankuese, kishte një shkëputje nga zingjiri komandues gjatë protestës të datës 10 shkurt 2007 (në raportin e tij të dytë, Prokurori special kishte konkluduar se, zingjiri komandues qe shkëputur, sepse sipas të kuptuarit e Komandantit të bashkërenduesve të FPU-së, roli i tij dhe përgjegjësitë dallonin nga ato të komandantëve të tij dhe vartësve të tij), kishte shkëputje edhe në zingjirin e mbikëqyrjes, në kuptimin se, mbikëqyrësit e policisë rumune të UNMIK-ut, nuk ishin në dijeni se këta të fundit ishin duke përdorur plumba gome gjat protestës të datës 10 shkurt 2007.

12. Palët ankuese më tutje ankohen për një numër dështimesh gjatë hetimeve të zhvilluara nga Grupi punues i policisë dhe Prokurori special. Ata kryesisht kritikojnë faktin se, hetimet nuk u kanë lejuar hetuesve që të identifikojnë se kush prej pjesëtarëve të policisë rumune të policisë së UNMIK-ut kishte qëlluar me të shtëna. Ata më tej pohojnë se, të gjitha raportet e policisë kishin një formulim identik të fjalëve dhe ishin të po të njëjtit format në tekstin e shtypur në gjuhën angleze, përkundër pyetjeve, nëse pjesëtarët rumunë të policisë së UNMIK-ut flisnin anglisht; se hetuesit kishin përfshirë personelin rumunë të UNMIK-ut, përkundër faktit të qartë se, të dyshuar ishin edhe pjesëtarët rumunë të policisë së UNMIK-ut; se transkriptet në gjuhën angleze ose përkthimet e intervistave të policëve rumunë pjesëtarë të policisë së UNMIK-ut, përmbanin informata të cilat nuk ekzistonin në versionin origjinal të shkruar me dorë në gjuhën rumune gjatë intervistave; se kishte mospërputhje të mëdha në dëshminë e së paku prej njërit prej pjesëtarëve rumunë të policisë së UNMIK-ut; se askush prej pjesëtarëve rumunë të policisë së UNMIK-ut, nuk ishte intervistuar në pajtim me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, që e bën të papranueshme çfarëdo dëshmie të paraqitur kundër tyre; dhe se nuk ishin marrë në pyetje të gjithë dëshmitarët relevant të ngjarjeve të datës 10 shkurt 2007.

b. Vlerësimi preliminar i Panelit

13. E drejta për jetë është e garantuar me, në mesin e dispozitave tjera, edhe me nenin 2 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) dhe nenit 6 të Konventës Ndërkombëtare për Drejtat Civile dhe Politike (CCPR). Këto nene përfshijnë disa nga vlerat themelore të shoqërive demokratike.

Nga pikëpamja e pavarur, nenet në fjalë, përcaktojnë rrethanat, në të cilat mund të justifikohet privimi nga jeta. Siç thuhet në mënyrë të qartë, në nenin 6 § 1 të Konventës Ndërkombëtare për Drejtat Civile dhe Politike (CCPR) është privimi nga jeta në mënyrë arbitrare, që është i ndaluar. Teksti i nenit 2 § 2 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *tutje* ECHR, vetëvetiu tregon se, përdorimi i forcës vdekjepruese nga policët mund të justifikohet në rrethana të caktuara. Mirëpo, çfarëdo përdorimi i forcës duhet të jetë “vetëm absolutisht i domosdoshëm” për arritjen e ndonjërit prej qëllimeve të përcaktuara në nënparagrafin (a), (b) ose (c) të paragrafit të fundit, përkatsisht, duhet të jetë rreptësisht në përputhje me rrethanat. Në kuptim të natyrës themelore të të drejtës për jetë, rrethanat në të cilat privohet jeta mund të justifikohet dhe duhet të shpjegohet saktësisht (shih ECHR, *Nachova and Others v. Bulgaria* [GC], nos. 43577/98 dhe 43579/98, § 94, ECHR 2005-VII).

Në përputhje me rrethanat, dhe duke iu referuar nenit 2 § 2 (c) të ECHR, qëllimi legjitim i shtypjes së trazirës ose rebelimit mund vetëm të justifikojë vënien e jetës së njeriut në rrezik, në rrethana të një domosdoshmërie absolute.

Duke marrë parasysh praktikën gjyqësore të ECHR, për rastet lidhur me përdorimin e forcës nga agjentët e shtetit, Paneli duhet të merr parasysh jo vetëm veprimet e agjentëve të UNMIK-ut, të cilët kishin administruar me forcën por, gjithashtu edhe me rrethanat e afërta, duke përfshirë çështjet e tilla si, korniza relevante ligjore ose rregulluese e vendosur, dhe planifikimi dhe kontrolli i veprimeve që janë nën ekzaminim (shih ECHR, *McCann and Others v. The United Kingdom*, vendimi 17 shtator 1995, Seria A no. 324, p. 46, § 150; ECHR, *Makaratzis v. Greece* [GC], no. 50385/99, §§ 56-59, ECHR, *Nachova and Others*, cituar më lart, § 93).

14. Neni 2 i ECHR dhe 6 i Konventës Ndërkombëtare për Drejtat Civile dhe Politike, *tutje* CCPR, gjithashtu nënkuptojnë një obligim procedural për UNMIK-un.

Lidhur me nenin 2 të ECHR, ky obligim është përshkruar në vijim nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Nachova* (të cituar më lart, §§ 110-113; parimet janë ripohuar së fundi në ECtHR, *Ramsahi v. Netherlands* [GC], no. 52391/99, § 321, 15 maj 2007):

“110. Obligimi për të mbrojtur të drejtën për jetë sipas nenit 2 të Konventës, lexohet në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit sipas nenit 1 të Konventës për “ t’i siguruar çdokujt brenda juridiksionit të [vet] të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë”, kërkon sipas nënkuptimit se, duhet të ketë ndonjë formë e hetimeve efektive zyrtare kur si pasojë e përdorimit të forcës vriten individët (shih *Çakici v. Turkey* [GC], no. 23657/94, § 86, ECHR 1999-IV). Qëllimi esencial i një hetimi të tillë është që të sigurohet zbatimi efektiv i legjislacionit vendor, që ruan të drejtën për jetë dhe, në ato raste përfshinë edhe agjentët e shtetit ose organet, për të siguruar llogaridhënien e tyre për vdekjet që janë shkaktuar nën përgjegjësinë e tyre (shih *Anguelaova v. Bulgaria*, no. 38361/97, § 137, ECHR 2002-IV).

111. Autoritetet duhet të veprojnë nga vetë mocioni i tyre, si të kenë marrë vesh për çështjen. Ata nuk duhet t’ia lënë çështjen iniciativës së familjarëve të afërt për të parashtruar zyrtarisht ankesë ose për të kërkuar hetime të veçanta ose procedura hetimore (shih, *mutatis mutandis*, *Ilhan v. Turkey* [GC], no. 22277/93, § 63, ECHR 2000-VII).

112. Në mënyrë që hetimi i një vrasjeje të pohuar si e paligjshme, e kryer nga agjentët e shtetit të jetë efektiv, personat përgjegjës për dhe zhvillimin e hetimeve duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm, në ligj dhe në praktikë (shih *Güleç v. Turkey*, vendimi of 27 July 1998, *Reports* 1998-§, p. 1733, §§ 81-82; *Oğur v. Turkey* [GC], no. 21594/93, §§ 91-92, ECHR 1999-III; and *Ergi v. Turkey*, vendimi 28 korrik 1998, *Reports* 1998-IV, pp. 1778-79, §§ 83-84).

113. Hetimi gjithashtu duhet të jetë efektiv, në kuptimin se është në gjendje të çojë deri te përcaktimi, nëse forca e përdorur ishte apo nuk ishte e justifikueshme në këto rrethana dhe deri te identifikimi dhe ndëshkimi i atyre personave që janë përgjegjës (shih *Oğur*, cituar më lart, § 88). Autoritetet është dashur të ndërmarrin hapa të arsyeshëm e të disponueshëm për ta, për të siguruar prova lidhur me incidentin, duke përfshirë, *mes tjerash*, dëshmitë prej dëshmitarëve okularë dhe provat e mjekësisë ligjore. Konkludimet e hetimit duhet të bazohen në analiza të tërësishme, objektive dhe të paanshme të të gjitha elementeve relevante dhe duhet të aplikojnë një standard të krahasueshëm me “vetëm absolutisht i domosdoshëm”, standard i cili kërkohet sipas nenit 2 § 2 të Konventës. Çfarëdo pamjaftueshmërie e hetimit, e cila rrënon aftësinë e hetimeve për konstatimin e rrethanave të rastit ose të personit përgjegjës, është përgjegjëse për dështimin e masave të kërkuara të efektshmërisë (shih *Kelly and Others v. The United Kingdom*, no. 30054/96, §§ 96-97, 4 maj 2001, dhe *Anguelova*, i cituar më lart, §§ 139 dhe 144).”

15. Në dritën e parimeve të njohura, Paneli konsideron se, ankesa lidhur me të drejtën për jetë, e shqyrtuar nga aspekti substancial dhe procedural, ngritë çështjen e ligjit dhe atë të faktit, përcaktimi i të cilave, do të duhet të varej nga ekzaminimi i meritës së ankesave. Paneli vlerëson se, ankesa nuk është e pabazë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së përmendur. Më tej, po ashtu vlerëson se, ankesa nuk është e papranueshme as për ndonjërin prej pikave të tjera.

2. Ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës

a. Parashtresat e palëve ankuese

16. Palët ankuese tregojnë se, rrethanat e rastit kanë bërë që ata t’i ekspozohen torturës apo trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, në kuptim të nenit 3 të ECHR, nenit 7

të CCPR dhe nenit 2 dhe 16 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese.

b. Vlerësimi preliminar i Panelit

17. Sikurse dispozitat e Traktatit për të drejtën për jetë, dispozitat e përmendura më lart ruajnë disa prej vlerave më themelore të shoqërisë demokratike.

Nga një pikëpamje e pavarur, dispozitat në fjalë, ndalojnë në kuptim absolut, torturën apo trajtimin çnjerëzor ose poshtues ose dënimin, pavarësisht prej rrethanave dhe sjelljes së viktimës (ECtHR, *Saadi v. Italy* [GC], no. 37201/06, § 127, 28 shkurt 2008). Për t'u përfshi brenda fushës së këtij ndalimi, keqtrajtimi duhet të arrijë nivelin minimal të ashpërsisë (ECtHR, *Ireland v. The United Kingdom* vendimi 18 janar 1978, Series A no. 25, p. 65, § 162).

Dispozitat në fjalë, mund të shkelen me përdorimin e forcës nga policia. Padyshim, ato nuk ndalojnë përdorimin e forcës në rrethana të caktuara, që janë të përcaktuara mirë, siç është shtypja e një trazire ose e një rebelimi. Mirëpo, një forcë e tillë mund të përdoret vetëm nëse është e domosdoshme dhe të mos jetë e tepëruar (krahaso ECtHR, *Eser Ceylan v. Turkey*, no. 14166/02, § 28, 13 dhjetor 2007).

18. Për nga pikëpamja procedurale, dispozitat në fjalë lënë të kuptohen se, kur një individ ngritë një kërkesë të vërtetueshme, se ka qenë i keqtrajtuar nga policia, atëherë duhet të ketë një hetim zyrtar efektiv. Përkitazi me një hetim lidhur me ndërhyrjen në të drejtën për jetë, një hetim i tillë duhet të jetë në gjendje dhe të çojë drejt identifikimit dhe ndëshkimit të personave përgjegjës (EctHR, *Matko v. Slovenia*, no. 43393/98, § 84, 2 November 2006).

19. Ankesa lidhur me ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor ose poshtues është e lidhur me ankesën lidhur me të drejtën për jetë. Sikurse në ankesën e fundit të përmendur, Paneli konsideron se ankesa e mëparshme, megjithëse e kufizuar në çështjen e trajtimit çnjerëzor, por që merret parasysh si nga aspekti i pavarur ashtu edhe ai procedural, e ngritë çështjen e ligjit dhe të faktit, përcaktimi i të cilave do të duhej të varej nga ekzaminimi i meritës së ankesave. Paneli vlerëson se, ankesa nuk është e pabazë në kuadër të kuptimit të nenit 3.3 të Rregullores në fjalë. Më tutje vlerëson se, ankesa nuk është papranueshme as për ndonjërin prej pikave të tjera.

3. E drejta për një seancë gjyqësore dhe e drejta për mjete juridike

a. Paraqitjet e palëve ankuese

20. Palët ankuese pohojnë se, pas raportit të dytë të Prokurorit special, nuk ka mjete të efektshme juridike të disponueshme për ta, sepse raportet nuk kanë çuar deri te kërkesa për iniciimin e një hetimi penal. Palët ankuese, po ashtu ankohen se, duket që nuk është bërë implementimi i ndonjë mënyre të përshtatshme për zgjidhjen e kontesteve, siç kërkohet me nenin 29 të Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetin e Kombeve të Bashkuara, në rrethanat ku ekziston një kontest që përfshinë një zyrtar të Kombeve të Bashkuara, i cili gëzon imunitet për shkak të pozitës së tij zyrtare.

Kjo ankesë mund të lidhet me nenin 6 dhe 13 të ECHR dhe nenin 2 § 3 dhe 14 të CCPR, të ngritur nga palët ankuese.

b. Vlerësimi preliminar i Panelit

21. Së pari Paneli vlerëson se, neni 6 § 1 i ECHR, deri më tani si relevant, garanton se, në përcaktimin e të drejtave civile dhe obligimeve të personit, çdo kush ka të drejtë për një seancë gjyqësore të drejtë brenda një kohe të arsyeshme. Në të njëjtën mënyrë, neni 14 § 1 i CCPR garanton se, në përcaktimin e të drejtës së personit në një akt padi, çdokush ka të drejtë në seancë gjyqësore të drejtë.

22. Paneli më tutje vlerëson se, neni 13 i ECHR dhe 2 § 3 i CCPR kërkojnë se, kur flitet për një shkelje të vështetueshme të një apo më shumë të drejtave në këtë çështje, duhet të ketë një mekanizëm i disponueshëm për viktimën për konstatimin e çfarëdo përgjegjësie të zyrtarëve të shtetit ose të organeve për atë shkelje. Autoriteteve publike u lejohet një masë e diskrecionit, lidhur me mënyrën se si pajtohen ata me obligimet që kanë sipas kësaj dispozite. Si rregull e përgjithshme, nëse një mjet i vetëm juridik, si i tillë nuk përmbushë kërkesat nga dispozitat e lartpërmendura, kjo mund të bëhet me anë të mjeteve juridike të bashkuara, të cilat janë paraparë me ligjin vendor (shih, në mesin e shumë autorëve, ECtHR, *Kudla v. Poland* [GC], no. 30210/96, § 157, ECHR 2000-IX; shih gjithashtu ECtHR, *Čonka v. Belgium*, no. 51564/99, § 75, ECHR 2002-I).

Shtirirja e obligimit sipas nenit 13 të ECHR dhe nenit 2 § 3 të CCPR, ndryshon varësisht nga natyra e ankesës së aplikuesit. Nga paraktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut del se, në situata të caktuara një mjet juridik i caktuar duhet të sigurohet. Prandaj, në rastet e vdekjeve të dyshimta ose të keqtrajtimit, duke marrë parasysh rëndësinë fundamentale të të drejtave të mbrojtura me nenin 2 dhe 3 të ECHR, nenin 13 të ECHR, kërkojnë që, përveç pagesës së kompensimit aty ku është e përshtatshme, të bëhet një hetim i plotë dhe efektiv, i cili do të jetë në gjendje të çojë deri te identifikimi dhe ndëshkimi i personave përgjegjës (shih ECtHR, *Assenov and Others v. Bulgaria*, vendimi 28 tetor 1998, Raporte 1998-VIII § 114 et seq.; ECtHR, *Anguelova v. Bulgaria*, no. 38361/97, §§ 161-162, ECHR 2002-IV; ECtHR, *Süheyla Aydin v. Turkey*, no. 25660/94, § 208, 24 maj 2005).

23. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit, Paneli konsideron se, kjo pjesë e ankesës ngritë çështje të ligjit dhe faktit, përcaktimi i të cilave do të duhej të varet nga ekzaminimi në bazë të meritës. Paneli vlerëson se, ankesa nuk është e pabazë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores në fjalë. Paneli më tej vlerëson se, ankesa nuk është e papranueshme as për ndonjërin prej pikave të tjera.

4. E drejta për tubim paqësor

a. Paraqitjet e palëve ankuuese

24. Palët ankuuese nuk bëjnë ndonjë paraqitje specifike në këtë aspekt

b. Vlerësimi preliminar i Panelit

25. Paneli vën re se, e drejta e lirisë për tubim është e drejtë fundamentale në një shoqëri demokratike dhe është një prej themeleve të një shoqërie të tillë (ECtHR, *Galstyan v. Armenia*, no. 26986/03, § 114, 15 nëntor 2007). Kjo e drejtë, për të cilën mbrojtja e mendimit personal paraqet njërin prej objektivave, i nënshtrohet një numri të përjashtimeve, të cilat duhet të interpretohen në kuptim të ngushtë, dhe domosdoshmëria për ndonjë kufizim duhet të konstatohet në mënyrë të bindshme. (ECtHR, *Osmani and Others v. The former Yugoslav Republic of Macedonia* (dec.), no. 50841/99, 11 tetor 2001).

16. Në dritën e parimeve të njohura, Paneli konsideron se, kjo pjesë e ankesës, ngritë çështjen e ligjit dhe atë të faktit, përcaktimi i të cilave do të duhet të varej nga

ekzaminimi i meritës së ankesave. Paneli vlerëson se, ankesa nuk është e papranueshme, as për ndonjërin prej pikave të tjera, në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores në fjalë. Paneli më tej vlerëson se, ankesa nuk është e papranueshme, as për ndonjërin prej pikave të tjera.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzërit,

DEKLARON SE ANKESA ËSHTË E PRANUESHME.

John Ryan
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues